

VENDIM
Nr. 165, datë 25.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 180, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGESËN E VLERËS SË MBETUR TË DETYRIMIT PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, NR. 43628/07, NR. 46684/07, NR. 34770/09, “MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 1, 4 dhe 5, të vendimit nr. 180, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për pagesën e pjesës së mbetur të detyrimit.

Për ankimin nr. 34770/09 në favor të znj. Shqipe Muka bëhet pagesa 680 000 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) euro në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.”.

“4. Pagimi i shumës për pjesën e mbetur të detyrimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, në favor të ankuesve, bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

Për vonesën në ekzekutimin e vendimit, bazuar në pagesat pjesore të kryera, do të paguhet interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind. Interesat do të llogariten nga data 18.3.2013 deri në datën e kryerjes së pagesës së plotë të principalit të detyrimit.

5. Efekti financiar për pagimin e interesave të përballohet nga fondi kontingjencës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama